



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 19.4.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Engin Beyoglu (me leje).

Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Kryesuesi propozoi që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, në pikën “të ndryshme”, të paraqitet edhe Informata lidhur me aktivitetin, parimet dhe misionin e Kryqit të Kuq të Kosovës, si dhe Informata lidhur me punën e Komisionit për udhëheqjen e punës në terren për zgjedhjet e kryetarëve të këshillave të bashkësive lokale.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të KPF - së;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit “Prek Jakova” në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen “Kodra e Trimave 1”;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
5. Propozimvendimi për garanci të kthimit të kredisë;
6. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 4

Pika e parë

Njësori u miratuan ekstraktet e procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të katërt të KPF-së.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Behxhet Musliu**.

Aziz Pacolli pyeti për arsyet e ndërrimit të lokacionit të caktuar më par për këtë destinim.

Behxhet Musliu u përgjigj në pyetjen e parashtruar nga z. Aziz Pacolli, duke shtuar se lokacioni i caktuar më herët nuk ka mund të realizohet për shkak të terrenit të papërshtatshëm.

Shefqet Sylejmani përkrahu këtë propozim, pasi që ky lokacion është i qëlluar për këtë destinim. Ne po përpiqemi të tregojmë kujdes që të bëhet një harmoni e caktimit të lokacioneve për shkollat. Nuk kam qenë i pajtimit për lokacionin e caktuar më herët në lagjen "Velania", dhe nuk do të ishte keq që të bisedohet për rregullimin e atij vendi, pasi që është një simbolikë e asaj pjese të qytetit, por ndërtimi i të gjitha atyre shtyllave, nuk është i paqëllimtë.

Tefik Mehmeti përkrahu këtë propozim.

Kryesuesi tha se këtij materiali i mungon fleta poseduese dhe skicat me të cilat duhet të plotësohet ky propozim.

Xhelil Bektashi i njoftoi të pranishmit se personat e vendosur në atë barakë, nuk posedojnë dokumentacionin e nevojshëm.

Agim Salihu shtoi se në hyrje të propozimvendimit mungon neni 12 dhe në nenin 2 në vend të paraqitjes së sipërfaqes me njësinë ar, duhet të jetë në m2.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës dhe baletit "Prenk Jakova" në Prishtinë, me ndryshime dhe plotësime, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Behxhet Musliu**.

Shemsi Veseli tha se materialit i mungon skica mbi gjendjen faktike dhe ajo e situacionit, andaj duhet të plotësohet.

Kryesuesi shtoi se kjo vërejtje është edhe e tij.

Aziz Pacolli kërkoi që objekti i shkollës dhe i çerdhes së fëmijëve të kryhen njëkohësisht.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen "Kodra e Trimave 1" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Arsyetimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Agim Salihu**.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah propozimvendimi për garanci të kthimit të kredisë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Të ndryshme

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se, për mbledhje e radhës të Kuvendit, në pikën “të ndryshme”, do të jetë edhe Informata lidhur me aktivitetin, parimet dhe misionin e Kryqit të Kuq të Kosovës, si dhe Informata lidhur me punën e Komisionit për udhëheqjen e punës në terren për zgjedhjet e kryetarëve të këshillave të bashkësive lokale.

Shemsi Veseli propozoi që në muajin shtator, të mbahen trajnime për dhënien e ndihmës së parë. Ai gjithashtu kërkoi dhënien e Informatës për tremujorin e punës, njëherësh sugjeroi që të bëhet një punë e vëmendshme me rastin e ndarjes së banesave të veteranëve të luftës.

Kryesuesi tha se kjo çështje është shumë e ndjeshme, andaj duhet të jemi shumë të vëmendshëm.

Shemsi Veseli shtoi se Komisioni duhet ta bëjë verifikimin e personave që janë duke banuar në ato banesa dhe, nëse konstatohet se janë të lëshuara me qira ose keqpërdoren, të revokohet vendimi.

Shfaqet Sylejmani u pajtua me të gjitha ato që tha z. Shemsi Veseli, njëherësh përsëriti qëndrimet e kryetarit dhe të kryesuesit, pasi që ashtu duhet të veprohet, në mënyrë që të zgjidhen problemet, si dhe të përshpejtohet procesi rreth punës së koncesionit në mes të investitorit dhe Komunës. Do të ishte mirë që banorët e objektivit ku do të ndërtohet shkolla e muzikës dhe nevojtarët e tjerë, të vendosen në disa objekte që janë uzurpuar, si të “Qendra” në Hajvali dhe të ish-Kazerma e Ushtrisë. Ai kërkoi që të bëhet trysni për zgjidhjen e problemeve në lagjen “Tophane”, si dhe zgjidhjen e çështjes së linjës nga “Kodra e Trimave” për në “Kodrën e Diellit”. Sa i përket propozimit lidhur me informatën e Kryqit të Kuq të Kosovës dhe Informatën e bashkësive lokale lidhur me punën e Komisionit për zgjedhjet e kryetarëve të këshillave të BL-ve, shtoi se është për atë që të informohemi në Kuvend.

Kryesuesi dha sqarime dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

Lidhur me pronësinë e objektit në Hajvali, disa sqarime i paraqiti **Shemsi Veseli**, duke shtuar se ai objekt ka qenë në menaxhimin e KFOR-it suedez, ndërsa është në pronësi të MAPL-së. Ai gjithashtu propozoi që nëse ky objekt nuk shfrytëzohet, do të ishte mirë që t'iu jepet në shfrytëzim personave në nevojë.

Milazim Vitia paraqiti kërkesën e banorëve të Hajvalisë lidhu me vendosjen e një stacioni policor në këtë lagje, për shkak të vjedhjeve të shumta që po bëhen në atë pjesë, si dhe ndërtimit të një objekti për një çerdhe për fëmijë. Nëse funksionalizohen bashkësitë lokale, atëherë ato duhet të pajisen me mjetet e nevojshme për punë.

Halim Halimi informoi lidhur me kërkesat e parashtruara nga Milazim Vitia.

Tefik Mehmeti tha se përveç problemeve të shumta të cilat i paraqiti Shefqet Sylejmani, është edhe problemi i mos mbylljes së gropave të shumta, të cilat mbesin si pasojë e kryerjes së punimeve të ndryshme dhe nuk mbyllen, andaj Drejtoria e Inspektionit dhe ajo e Shërbimeve Publike, duhet të angazhohen më shumë edhe në pastrimin e mbeturinave. Te ish-Fabrika e Tjegullave, edhe pse gropa ka filluar të mbulohet, mbeturinat kanë arritur në afërsi të shtëpive. Duhet të punohet më shumë dhe më shpejtë në pastrimin e mbeturinave, mbylljen e kanalizimeve, por edhe të punëve të tjera.

Behxhet Musliu paraqiti sqarime lidhur me banesat e dhëna me konsesion te kompleksi banesor "Dielli". Informoi se nga ana e Këshillit të Drejtorëve është shqyrtuar edhe Plani për Zonën Ekonomike, i cili pritet që të shqyrtohet edhe nga shefat e grupeve parlamentare, pastaj edhe në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30.

PROCESMBAJTËSJA

Alije Gusia

KRYESUESI I KOMITETIT

Sami Hamiti, ecc. i dipl.